

V E N D I M
Nr.196, datë 6.4.2001

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.231, DATË 11.5.2000, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PRANIMIN NË SHËRBIMIN CIVIL DHE PERIUdhËN E PROVËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 29 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.231, datë 11.5.2000 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 7, ndryshohet si vijon:

“7. Departamenti i Administratës Publike, me shpenzimet e institucionit në vendin e lirë, boton shpalljen e konkurimit për vendin e lirë, për 6 ditë me radhë, në disa nga gazetatat me qarkullim më të madh. Botimi bëhet, të paktën, 40 ditë para datës së caktuar për zhvillimin e testimit. Në institucionet e pavarura botimi bëhet nga departamenti, drejtorja, seksioni apo zyra e personelit”.

2. Pika 20, ndryshohet si vijon:

“20. Departamenti i Administratës Publike, për institucionet e administratës qendrore ose departamenti, drejtorja, seksioni apo zyrat e personelit, për institucionet e pavarura, brenda 4 ditëve nga dhënia e vendimit të eprorit direkt, botojnë emrat e fituesve, për tri ditë me radhë, në disa nga gazetatat me qarkullim më të madh”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta